



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU -BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.15/24

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit T.L., nga Prizreni, ndaj gjyqtarit Sh.Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile CN.nr.38/24, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.22.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit T.L., nga Prizreni, ndaj gjyqtarit Sh.Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile CN.nr.38/24.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës T.L., nga Prizreni, në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit Sh.Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile CN.nr.38/24.

Ankuesi T.L., në kërkesën e parashtruar, ka deklaruar se me datë 30.09.2024 është mbajtur seanca gjyqësore për lëndën me numër 2021 :242967 për parcializimin e tokës në të cilën, ankuesi T.L., është bashkëpronar. Në seancë i njëjti ka kërkuar të drejtën për fjalë dy herë dhe gjyqtari Sh.Sh., i ka thënë "prit pak" dhe përkundër faktit se ankuesi ka pritur për të drejtën e fjalës, kjo nuk ka ndodhur. Pra, gjyqtari nuk ia ka dhënë të drejtën e fjalës asnjëherë edhe pse ankuesi është bashkëpronar i tokës për të cilën është mbajtur seanca. Kjo qasje e gjyqtarit bie në kundërshtim edhe me Kodin e Etikës së Gjyqtarit ku specifikohet se palët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesë ndaj gjyqtarit Sh.Sh., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni

Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile CN.nr.38/24 ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes.

Gjyqtari në deklaratën e tij lidhur e pretendimet e ankuesit ka cekur se propozimi Për ndarje fizike të palujtshmërisë në gjykatë është dorëzuar me dt.29.10.2021 me te cilin është kërkuar ndarja fizike lidhur më ngastrën kadastrale 657-0 ZK Lubizhdë. Ndërsa në shqyrtimin e dt.26.07.2022 i autorizuari i propozuesve av.N.K., ka zgjeruar propozimin per ndarje fizike duke përfshirë edhe ngastrën kadastrale 103-0 ZK Petrovë. Lidhur më këtë çështje gjykata ka mbajtur disa shqyrtime gjyqësore, ku me dt.28.12.2022 pas mbajtjes Së shqyrtimit përgatitor ka vendosur që të dilet ne vendin e ngjarjes me ekspertë të gjeodezisë me qëllim të ndarjes fizike. Pas mbajtjes Së këtij shqyrtimi konkretisht me parashtresën e dt. 13.01.2023 propozuesi Ar.B., ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit gjykues me arsyetim se nuk e ka ndërprere shqyrtimin dhe çështjen nuk e ka dërguar në kontest. Duke vepruar sipas këtij propozimi gjykata në shqyrtimin e dt.21.02.2023 e ka ndërprere shqyrtimin dhe lenden ia ka përcjelle Kryetares per të vendosur lidhur më përjashtimin. Kryetarja e gjykatës me aktvendimin IV.Gja.nr. 1/2023-36 të dt. 13.03.2023 e ka refuzuar kërkesën per përjashtimin e gjyqtarit gjykues si të pa bazuar.

Gjykata me aktvendimin CN.nr.534/21 te dt. 17.10.2023 e ka ndërprerë procedurën per shkak të vdekjes Së propozueses R.G-B., ndërsa i autorizuari i propozuesve av.N.K., më parashtresën e dt.20.11.2023 ka propozuar vazhdimin e procedurës. Kështu që, gjykata me dt.30.09.2024 ne ora 13:30 ka dal ne vendin e ngjarjes ku kanë prezantuar i autorizuari i propozuesve av.N.K., kundër propozuesi A.B., , kundër propozuesi A.B., dhe i autorizuari i tij av.Y.K., si dhe eksperti i gjeodezisë Kadri Gashi. Gjykata në këtë shqyrtim me ndihmën e ekspertit ka bërë identifikimin e ngastrave kadastrale të cilat janë lëndë e ndarjes fizike dhe ka regjistruar në procesverbal deklarimet esenciale të palëve (më hollësisht sikurse në këtë procesverbal). Ndërsa nuk qëndron pretendimi i propozuesit T.L., se të njëjtit nuk i është dhënë mundësia të flas per shkak se te njëjtin ne këtë çështje e përfaqëson av.N.K., i cili ne këtë shqyrtim është deklaruar, përpos tjerash edhe ne emër të tij. Gjykata, gjithashtu sqaron se gjatë daljes në vendin e ngjarjes me ekspert të lëmisë përkatëse roli dhe funksioni i ekspertit është vendimtar, sikurse në këtë rast ku eksperti i gjeodezisë ka ndërmarrë veprime Për identifikim dhe konstatimin e gjendjes faktike lidhur më ngastrat kadastrale 657-0 dhe 103-0 të cilat janë lëndë e kesaj çështje ku te njëjtit nga gjykata i është urdhëruar që gjatë përpilimit të raportit parimisht të merr Për bazë ndarjen fizike me nga 1/4 pjese ideale. Nga të dhënat e cekura sikurse më lartë gjyqtari i çështjes konsideron se nuk ka bërë kurrfarë Shkelje te cilat do ti përkisnin natyrës disiplinore, por te gjitha veprimet e ndërmarra bazohen në dispozita ligjore. Si do që të jetë kjo kërkesë ne fakt nuk i plotëson kushtet ligjore nga neni 5 të Ligjit nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ngase e njëjta qartazi është e pa bazuar dhe jo serioze, andaj i propozon Kryetares që kerkesën ta hedh poshtë bazuar në nenin 9 par.6 të këtij ligji.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar deklaratën nga gjyqtari i çështjes, ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës CN.nr.38/24.

Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mblledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:


Në Gjykatën Themelore ne Prizren — Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me date 29.10.2021 është parashtruar propozimi Për ndarje fizike nga propozuesit R.G.N., N.B., , T.L., A.M., dhe E.K., me kundër propozues A.B., A.B., dhe M.O.. Gjykata në këtë çështje me aktvendimin CN.nr.534/21 të datës 17.10.2023 ka marrë vendim për ndërprerjen e procedurës në këtë çështje juridike jo kontestimore Për shkak të vdekjes së propozueses R.G.. I autorizuari i propozuesve av.N.K., me date 20.11.2023 ka parashtruar kërkesë Për vazhdimin e procedurës së ndërprere, me q'rast lënda ka marrë numër të ri CN.nr.38/24. Në këtë çështje me datë 30.09.2024 është mbajtur seanca e daljes në vend ngjarje, ku kanë prezantuar i autorizuari i propozuesve av.N.K., kundër propozuesi A.B., dhe A.B., dhe i autorizuari i tij av.Y.K., si dhe eksperti i gjeodezisë Kadri Gashi. Pretendimi i ankuesit T.L., Për mosdhënien e drejtës së fjalës, nuk qëndron pasi që i njëjti përfaqësohet nga i autorizuari i tij av.N.K., i cili ka të drejta të plota Për përfaqësimin e palës dhe i njëjti gjatë kësaj seance është deklaruar edhe në emër të ankuesit T.L.. Për më tepër në këtë çështje paraqiten shumë palë si propozues dhe kundër propozues, ku të gjithë propozuesit përfaqësohen nga i njëjti përfaqësues av.N.K.. Shqyrtimi gjyqësor është në rrjedhë e sipër dhe secila palë do të ketë të drejtë të deklarohet personalisht ose edhe nëpërmjet të autorizuarit të tyre . Rëndin dhe mirëvajtjen e shqyrtimit e mban vet gjyqtari bazuar në situatën konkrete në vend të ngjarjes . Seanca e Cila mbahet në vend të ngjarjes ka Për qëllim që eksperti të bëjë matjen dhe të parashtron raport në lidhje me kërkesën e palëve dhe urdhrin e gjykatës , ndërsa seanca të rregullta të cilat mbahen në gjykatë mundësojnë deklarimin e palëve në kontest. Deri më tani në veprimet e gjyqtarit lidhur me këtë çështje jo kontestimore nuk janë vërejtur që të ketë shkelje disiplinore Siq pretendohet nga ana e ankuesit. Gjyqtari deri më tani ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPJK-së dhe LPK-së. Për veprimet procedurale të cilat kontestohen nga ana e palëve secila palë ka të drejtë ankesë të rregullt në fund të procedurës kontestimore dhe kur vendoset në mënyrë meritore në gjykatën e shkallës së dytë.

Andaj, si Autoritet Kompetent bazuar në të lartcekura konsideron se gjyqtari Sh.Sh., në veprimet e tij nuk ka pasur Shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë Shkelje sa i përket sjelljes, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.

Për arsyet e cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 Për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE Në PRIZREN
AD-GJTHPZ.nr.15/2024, me dt.22.11.2024

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e nakesës.